

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 17, datë 5.8.2020

PËR RREGULLAT E ZBATIMIT TË PARIMIT TË ROTACIONIT NË CAKTIMIN E AVOKATËVE, QË DO TË OFROJNË SHËRBIME TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE NË PROCESET CIVILE DHE ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 9, shkronja “b”, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ministri i Drejtësisë dhe kryetari i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë

UDHËZOJNË:

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR PËRGATITJEN E LISTAVE DHE RENDITJEN E AVOKATËVE NË LISTA

1. Ky udhëzim ka për qëllim miratimin e rregullave të hollësishme për përgatitjen e listave dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative, për çdo vit kalendarik, në përputhje me parimin e rotacionit, i cili garanton një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

2. Thirrja për shprehjen e interesit shpallet në faqen zyrtare të Dhomës së Avokatëve të Shqipërisë, brenda datës 20 dhjetor të vitit paraardhës. Avokatët paraqesin shprehjen e interesit nëpërmjet plotësimit të formularit të aplikimit, sipas modelit të përcaktuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë. Thirrja përmban afatin, brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, adresën postare ose elektronike ku duhet të dorëzohet shprehja e interesit dhe dokumentet përkatëse.

3. Listat e avokatëve që ofrojnë ndihmën juridike dytësore përgatiten të ndara për çdo dhomë avokatie vendore. Në lista renditen vetëm anëtarët aktivë të dhomës vendore të avokatisë përkatëse.

4. Për organizimin e procedurave të hedhjes së shortit dhe dokumentimin e çdo faze krijohet një Sekretariat Teknik. Përbërja e Sekretariatit Teknik dhe numri i anëtarëve caktohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.

5. Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, jo më vonë se data 20 janar e çdo viti kalendarik, cakton datën për organizimin e shortit në një ambient të përshtatshëm dhe njofton paraprakisht kryetarët e dhomave vendore të avokatisë, Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Njoftimi përmban datën, orën dhe vendin e zhvillimit të shortit.

6. Mosparaqitja e përfaqësuesve të institucioneve, të përcaktuara në pikën 5 të këtij udhëzimi, nuk pezullon procedurat e hedhjes së shortit.

7. Renditja e avokatëve në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore për çdo dhomë kryhet me short. Hedhja e shortit për renditjen e avokatëve u nënshtrohet parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të këtij procesi.

8. Shorti organizohet në tri kuti transparente. Në njërën vendosen goglat bosh, në kutinë tjetër vendosen shiritat ku janë shënuar emrat e avokatëve që do të ushtrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore. Në enën e tretë vendosen goglat, pasi në to janë futur shiritat me emrat e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike.

9. Radha e futjes së goglave në kuti dhe radha e hedhjes së shortit për çdo dhomë vendore të avokatisë përcaktohet duke filluar me hedhjen e shortit për dhomat vendore që kanë numrin më të madh të avokatëve që do të ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore.

10. Sekretari i Përgjithshëm i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë ose një përfaqësues i Sekretariatit Teknik i caktuar prej tij, drejton procesin dhe lexon me zë të lartë emrin e avokatit që është i shënuar në të dhe ia tregon Sekretariatit Teknik dhe të gjithë përfaqësuesve pjesëmarrës. Shiriti i letrës që gjendet brenda saj i dorëzohet Sekretariatit Teknik.

11. Avokati, emri i të cilit është shënuar në shiritin e letrës, renditet i pari në listën e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, për dhomën në të cilën është hedhur shorti.

12. Me të njëjtin short dhe të njëjtën procedurë, të parashikuar në pikën 10, të këtij udhëzimi, caktohet renditja në listë e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, për dhomën në të cilën është hedhur shorti.

13. Rezultatet e shortit dhe renditja e avokatëve që do të ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, për çdo dhomë shpallen nga kryetari i Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë.

14. Procedura e hedhjes së shortit regjistrohet në audio dhe video. Për dokumentimin e çdo faze të procedurës së organizimit dhe të hedhjes së shortit, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi, mbahet procesverbal. Rezultatet e shortit, së bashku me një relacion për procesin e organizimit të shortit bëhen menjëherë publike në faqen zyrtare të internetit të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.

15. Miratimi i listave përfundimtare të avokatëve, që ofrojnë ndihmën juridike dytësore, realizohet nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, brenda datës 1 shkurt të çdo viti kalendarik, nëpërmjet shortit.

16. Lista e avokatëve, për çdo dhomë, përmban edhe informacionin mbi specializimin e avokatit në fusha të së drejtës, kur specializimi është i nevojshëm, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, të viktimave dhe në raste të tjera të përcaktuara në ligj.

17. Pas miratimit përfundimtar të listave, ato përcillen për publikim në faqen zyrtare të DHASH-së të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe të Drejtorisë së Ndihmës Juridike. Kopje e listave u dërgohet dhomave vendore të avokatisë.

18. Lista e miratuar e avokatëve që do të ofrojnë shërbimet të ndihmës juridike dytësore, sipas dhomave vendore të avokatisë, është e vlefshme deri me 31 janar të vitit pasardhës.

KREU II PROCESI I CAKTIMIT TË AVOKATËVE

19. Dhoma vendore e avokatisë, brenda 8 orëve nga marrja e vendimit të gjykatës për pranimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore, cakton një avokat nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në juridiksionin e dhomës, sipas radhës në listë, duke filluar nga avokati i renditur i pari, sipas procedurave të shortit. Përzgjedhja e avokatëve me rotacion realizohet në mënyrë të njëpasnjëshme nga lista, duke filluar nga avokati i renditur i pari e me radhë në rend zbritës. Dhoma vendore menjëherë njofton Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas për caktimin e avokatit.

20. Në rast se numri i vendimeve të gjykatave për pranimin e kërkesave për dhënien e ndihmës juridike dytësore është më i madh se numri i avokatëve që ofrojnë këtë shërbim, Dhoma Vendore e Avokatisë cakton avokatët, duke rifilluar nga avokati i renditur i pari në listë, e me radhë në rend zbritës.

21. Në rast se shërbimi që do të kryhet kërkon njohuri të specializuara, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, të viktimave dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj, Dhoma Vendore e Avokatisë cakton avokatin më të parë, të renditur në listë, i cili është i specializuar në fushën e së drejtës

përkatëse. Për çdo çështje tjetër, që kërkon njohuri të specializuara në të njëjtën fushë të së drejtës, caktohet avokati i renditur më poshtë në listë, që është i specializuar në atë fushë të së drejtës.

22. Në rast se lista e miratuar e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore nën juridiksionin e një dhome, nuk ka avokatë që kanë njohuri të specializuara, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, të viktimave dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj, Dhoma e Avokatisë të Shqipërisë, pas njoftimit të marrë nga dhoma vendore cakton, një nga avokatët nga radha e avokatëve që janë të specializuar në fushën e kërkuar nga lista e miratuar e Dhomës Vendore të Avokatisë më të afërt me të. Në këtë rast, për caktimin e avokatit njoftohet edhe Dhoma Vendore e Avokatisë që ka nën juridiksion avokatin.

23. Dhoma e Avokatisë të Shqipërisë kryen trajnime të posaçme për avokatët në ato fusha ku specializimi është i nevojshëm, në rast se lista e miratuar e avokatëve, që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore, nën juridiksionin e një dhome, nuk ka avokatë me njohuri të specializuara.

24. Dhoma Vendore e Avokatisë i cakton avokatët nga lista e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore nën juridiksionin e dhomës, sipas radhës në listë, sipas parashikimeve të pikave 19 dhe 20, të këtij udhëzimi. Për çështjet që kërkojnë njohuri të specializuara avokatët caktohen sipas parashikimeve të pikave 21 dhe 22, të këtij udhëzimi.

25. Dhoma Vendore e Avokatisë kontakton me telefon dhe nëpërmjet postës elektronike me avokatin e caktuar në detyrë, sipas radhës në listë. Në rast se avokati pas njoftimit të tij, refuzon marrjen përsipër të detyrës, vijohet me kontaktimin e avokatit të radhës në listë. Refuzimi për marrjen përsipër të detyrës kryhet nga avokati me shkrim, duke përcaktuar edhe shkaqet e refuzimit.

26. Në rast se avokati nuk i përgjigjet telefonatës/postës elektronike, atij i lihet një kohë e arsyeshme, por në çdo rast jo më shumë se 24 orë, për të kthyer përgjigje. Në rast të moskthimit të telefonatës/postës elektronike, dhoma vendore e avokatisë telefonon menjëherë avokatin e radhës në listë.

27. Me marrjen e konfirmimit nga avokati, sipas procedurës së mësipërme, dhoma vendore e avokatisë merr vendim për caktimin e avokatit. Format i vendimit për caktimin e avokatit bëhet sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

28. Për dokumentimin e çdo faze të procedurës së njoftimit të avokatit të caktuar në detyrë, sipas radhës në listë, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi, mbahet procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga kryetari i Dhomës Vendore të Avokatisë, si dhe nëpunësi i dhomës përgjegjës për njoftimin e avokatëve të caktuar në detyrë.

29. Dhoma vendore e avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj mbi caktimin e avokatit edhe personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.

30. Nëse avokati i caktuar për të ofruar ndihmën juridike ka pengesa ligjore, sipas parashikimeve të nenit 9, të ligjit nr. 55/2018, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, i drejtohet me një kërkesë të arsyetuar dhomës vendore të avokatisë.

31. Nëse dhoma vendore e avokatisë vlerëson se kërkesa përmban shkaqe të arsyeshme, bën zëvendësimin e avokatit që ka hequr dorë nga përfaqësimi, duke njoftuar menjëherë Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas. Avokati zëvendësues caktohet referuar numrit të parë të lirë në listën e avokatëve.

32. Kur dhoma vendore e avokatisë e vlerëson kërkesën të pabazuar, refuzon zëvendësimin e avokatit. Në rast se avokati refuzon përsëri të ndjekë çështjen, dhoma vendore e avokatisë fillon procedurën e zëvendësimit dhe njofton Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë për fillimin e procedimit disiplinor.

33. Avokati do të vazhdojë të qëndrojë në detyrë derisa ai të zëvendësohet me një avokat tjetër nga dhoma vendore e avokatisë.

KREU III
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

34. Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë mbikëqyr zbatimin e parimit të rotacionit nga dhomat vendore të avokatisë.

35. Dhomat vendore të avokatisë mbajnë regjistër me të dhënat e ofrimit të ndihmës juridike dytësore, sipas formateve të miratuara nga ministri i Drejtësisë.

36. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, dhomat vendore të avokatisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

KRYETAR I DHOMËS SË AVOKATISË SË SHQIPËRISË
Maksim Haxhia

SHTOJCË NR. 1
(Formati i vendimit për caktimin e avokatit)

DHOMA VENDORE E AVOKATISË _____

NR. _____ VENDIMI

DATË ____.

VENDIM

Në _____, sot, më datë _____.20____, unë _____, përfaqësues për ndihmën juridike pranë Dhomës së Avokatisë _____, pasi u njoha me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor _____ nr.____, datë____, konstatova se kërkuesi _____, në bazë të vendimit është përfitues i ndihmës juridike dytësore.

Në mbështetje të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe në bazë të udhëzimit nr.____, datë____, “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmën juridike”,

VENDOSA:

- Caktimin e avokatit _____, me nr. licence _____ për të ofruar shërbimin juridik për kërkuesin _____, sipas vendimit të gjykatës bashkëngjitur këtij vendimi.
- Një kopje e vendimit do t’i dërgohet avokatit të caktuar dhe një kopje kërkuesit.

Përfaqësuesi
